

---

# KODI I PRAKTIKËS I STATISTIKAVE EVROPIANE

---

*Për Autoritetet Statistikore Kombëtare dhe  
Eurostat (autoriteti statistikor i BE -së)*

Miraturar nga  
Komiteti i Sistemit Statistikor Evropian

16 nëntor 2017

**eurostat** 



EUROPEAN  
STATISTICAL  
SYSTEM

*Shtypur nga Imprimerie Centrale në Luksemburg*

Dorëshkrimi përfundoi në nëntor 2017

As Komisioni Evropian dhe as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2018

© Bashkimi Evropian, 2018

Ripërdorimi është i autorizuar nëse burimi citohet.

Mënyra e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian rregullohet me Vendimin 2011/833/BE (OJ L 330, 14.12.2011, f. 39).

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose materialeve të tjera që nuk janë nën të drejtën e autorit të BE-së, duhet kërkuar leje drejtpërdrejt nga mbajtësit e të drejtave të autorit.

Print	PDF
ISBN 978-92-79-80006-1	ISBN 978-92-79-80014-6
doi:10.2785/914491	doi:10.2785/798269
KS-02-18-142-EN-C	KS-02-18-142-EN-N

---

# KODI I PRAKTIKËS I STATISTIKAVE EVROPIANE

---

***Për Autoritetet Statistike Kombëtare dhe  
Eurostat (autoriteti statistikor i BE -së)***

Miratur nga  
Komiteti i Sistemit Statistikor Evropian

16 nëntor 2017

# Parathënie

## Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane është guri i themelit i kornizës së përbashkët për cilësinë në Sistemit Statistikor Evropian.

Është instrument vetërregullues dhe bazohet në 16 Parime të cilat mbulojnë mjedisin institucional, proceset dhe rezultatet e prodhimit statistikor. Udhëzuesit dhe referencat për zbatimin e Kodit të Praktikës sigurohen nga grupi i treguesve (indikatoreve) që janë praktike dhe sigurojnë standarde për secilin nga Parimet, kështu duke rritur transparencën e Sistemit Statistikor Evropian.

Autoritetet statistikore, të përfshira nga Autoriteti Statistikor i Bashkimit Evropian (Eurostat), Institutet Statistikore Kombëtare dhe autoritetet e tjera kombëtare që janë përgjegjëse për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e Statistikave Evropiane, përkushtohen që t'i përmbahen Kodit të Praktikës.

Bordi Këshillëdhënës i Qeverisjes Statistikore Evropiane<sup>1</sup> (ESGAB, Bordi), si Bord i pavarur, ofron pasqyrën e Sistemit Statistikor Evropian lidhur me zbatimin e Kodit të Praktikës. Bordi analizon zbatimin e Kodit nga Autoriteti Statistikor i Bashkimit Evropian (Eurostat) dhe Sistemi Statistikor Evropian çdo vit; ofron këshilla për masat e duhura që duhet të ndërmerren për të lehtësuar zbatimin e Kodit të Praktikës, për ndërlidhjen e tij me përdoruesit dhe ofruesit e të dhënave dhe për përditësimet e mundshme.

Ky botim i vitit 2017 është rishikimi i dytë i Kodit të Praktikës, i miratuar së pari në vitin 2005. Ky botim pasqyron ndryshimet dhe të rejat e fundit lidhur me zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në Sistemin Statistikor Evropian dhe më gjerë, siç janë burimet e reja të të dhënave, përdorimi i teknologjive të reja, modernizimi i kornizës ligjore dhe rezultatet nga vlerësimet e kolegëve (peer review).

Fjalori që shpjegon shprehjet e përdorura në Kodin e Praktikës është në dispozicion në internet në

<http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/quality/overview>.

## Korniza e Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian

Korniza e Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian përbëhet nga Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane, Korniza e Sigurimit të Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian dhe parimet e menaxhimit të cilësisë (sic është ndërveprimi i vazhdueshëm me përdoruesit, përkushtimi i udhëheqësve, partneriteti, kënaqshmëria e stafit, përmirësimi i vazhdueshëm, integrimi dhe harmonizimi).

Kjo kornizë vetërregulluese e cilësisë plotëson kornizën ligjore të Sistemit Statistikor Evropian të bazuar në Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 mbi statistikën evropiane, e cila rrjedh nga Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Statistikat dhe shërbimet Evropiane zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen nën kornizë të fuqishme ligjore dhe cilësore.

Deklarata e Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian, e përfshirë në faqet pasuese në këtë broshurë, demonstroi ndërgjegjësimin mbi cilësinë që ekziston në Sistemin Statistikor Evropian, si dhe vetë-përkushtimin e të gjithë anëtarëve të saj për të zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme statistika dhe shërbime të tjera Evropiane me cilësi të lartë, në mënyrë që të sigurohet vlerë e qëndrueshme të përdoruesit.

<sup>1</sup> Bordi Këshillëdhënës i Qeverisjes Statistikore, Evropiane: <http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/esgab/introduction>



# Deklarata e Cilësisë e Sistemit Statistikor Evropian

Sistemi Statistikor Evropian (SSE) është partneritet ku bashkëpunojnë Eurostat dhe autoritetet statistikore kombëtare të secilit vend anëtar të BE-së dhe vendet e EFTA-s. Misioni është të sigurohet informacion i pavarur statistikor i cilësisë së lartë, në nivelet evropiane, kombëtare dhe rajonale, dhe ky informacion të jetë i disponueshëm për të gjithë vendimmarrësit, hulumtuesit, si dhe për debat.

Programi dhe përparësitë e statistikave evropiane diskutohen dhe bien dakord nga anëtarët e SSE me vendimet përfundimtare, të cilat marrën në mënyrë demokratike sipas procedurave legislative evropiane.

Ne veprojmë nën regjim<sup>1</sup> të rreptë ligjor, të plotësuar nga një kornizë e fuqishme ligjore e klasit botëror, që rregullon cilësinë, shtylla kurrizore e të cilit është Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane<sup>2</sup>. Përputhshmëria jonë me Kodin e Praktikës vlerësohet në baza periodike me anë të mekanizmave të rishikimit (peer review) dhe ndjek rreptë veprimet<sup>3</sup> që cojnë në përmirësim.

Ne e shohim cilësinë si bazë të përparësisë në një botë konkurruese që po përjeton rritjen e trendit për informacion të menjëhershëm, i cili shpesh nuk e ka dëshminë e nevojshme të cilësisë. Puna jonë drejtohet nga pavarësia profesionale, trajtimi i paanshëm i të gjithë përdoruesve, objektiviteti, besueshmëria, konfidencialiteti statistikor dhe kost-efektiviteti. Zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e statistikave tona bazohet në metodologji të mirëfillta, në standardet më të mira ndërkombëtare dhe në procedurat e dokumentuara, në mënyrë transparente. Parimet tona të cilësisë janë: rëndësia (ose relevanca), saktësia, afati kohor dhe përpikëria, qasja dhe qartësia, si dhe krahasueshmëria dhe koherenca.

Ne vazhdimisht përpiqemi të ulim ngarkesën e të anketuarve, të kultivojmë bashkëpunim të mirë me ofruesit e të dhënave dhe të bashkëpunojmë me grupet e palëve të interesuara, përfshirë komunitetet shkencore.

Ne jemi të përkushtuar të arrijmë përsosmëri statistikore duke identifikuar sistematikisht përparësitë dhe mangësitë tona, si dhe rreziqet që lidhen me to, të cilat i marrim parasysh nga zhvillimi i vazhdueshëm i kornizës së cilësisë. Duke modernizuar, inovuar dhe përpiluar tregues të rinj, ne jo vetëm që përmirësojmë cilësinë e produkteve dhe shërbimeve tona, por gjithashtu përpiqemi të parashikojmë fenomenet dhe nevojat e përdoruesve tanë.

**Drejtuesit e Instituteve Statistikore  
Kombëtare dhe Drejtori i Përgjithshëm i  
Eurostatit**

<sup>1</sup> Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:C:2016:202:FULL&from=EN> dhe Rregullorja (KE) Nr. 223/2009 mbi statistikat evropiane të ndryshuar me Rregulloren (BE) 2015/759: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/PDF/?uri=CELEX:02009R0223-20150608&from=EN>

<sup>2</sup> Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane: <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5921861/KS-32-11-955-EN.PDF> dhe Korniza e Sigurimit të Cilësisë i SSE: <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/64157/4392716/ESS-QAF-V1-2final.pdf/bbf5970c-1adf-46c8-afc3-58ce177a0646>

<sup>3</sup> Raundi i parë dhe i dytë i vlerësimeve të kolegëve i SSE: <http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/quality/first-round-of-peer-revieës> & <http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/quality/peer-revieës>

## Mjedisi institucional

Faktorët institucionalë dhe organizativë kanë ndikim të rëndësishëm në efektivitetin dhe besueshmërinë e autoritetit statistikor që zhvillon, prodhon dhe shpërndan Statistikat Evropiane. Parimet përkatëse janë pavarësia profesionale, bashkërendimi dhe bashkëpunimi, mandati për mbledhjen e të dhënave, përshtatshmëria e burimeve, përkushtimi ndaj cilësisë, konfidencialiteti statistikor, paanësia dhe objektiviteti.

### PARIMI 1

#### Pavarësia profesionale

Pavarësia profesionale e autoriteteve statistikore nga departamentet dhe organet e tjera rregullatore ose administrative, si dhe nga operatorët e sektorit privat, siguron kredibilitetin e Statistikave Evropiane.

TREGUESI

- 1.1 Pavarësia e Instituteve Statistikore Kombëtare dhe Eurostatit nga ndikimi politik ose ndikime të tjera të jashtme, në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave është e specifikuar me ligj dhe e siguruar për autoritetet statistikore.
- 1.2 Udhëheqësit e Instituteve Statistikore Kombëtare dhe të Eurostatit dhe, kur vlen, udhëheqësit e autoriteteve të tjera statistikore, kanë autoritet të mjaftueshëm hierarkike për të siguruar qasje te autoritetet e politikave dhe organet administrative publike. Ata janë të kalibrit më të lartë profesional.
- 1.3 Udhëheqësit e Instituteve Statistikore Kombëtare dhe të Eurostatit dhe, ku vlen, udhëheqësit e autoriteteve të tjera statistikore kanë përgjegjësinë për të siguruar zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave në mënyrë të pavarur.
- 1.4 Udhëheqësit e Instituteve Statistikore Kombëtare dhe të Eurostatit dhe, aty ku vlen, udhëheqësit e autoriteteve të tjera statistikore, kanë përgjegjësinë për të vendosur për metodat, standardet dhe procedurat statistikore, dhe përmbajtjen dhe afatet e publikimeve statistikore.
- 1.5 Plani statistikor i punës publikohet dhe bëhen raporte periodike mbi progresin e arritur në realizimin e tij.
- 1.6 Publikimet statistikore ndahen qartas nga deklaratat politike/të politikave.

1.7 Instituti Statistikor Kombëtare dhe Eurostat dhe, aty ku vlen, autoritetet e tjera statistikore, komentojnë publikisht mbi çështjet statistikore, përfshirë kritikën dhe keqpërdorimet e statistikave, nëse konsiderohet e përshtatshme.

1.8 Emërimi i udhëheqësve të Instituteve Statistikore Kombëtare dhe Eurostatit dhe autoriteteve të tjera statistikore bëhet vetëm mbi bazën e kompetencës profesionale. Arsyet mbi bazën e të cilave ky post mund të përfundojë janë të specifikuar në kornizën ligjore. Këto nuk mund të jenë arsye, që komprometojnë pavarësinë profesionale ose shkencore.

### PARIMI 1bis

#### Bashkërendimi dhe bashkëpunimi

Institetet Statistikore Kombëtare dhe Eurostat sigurojnë bashkërendimin (ose koordinimin) e të gjitha aktiviteteve në drejtim të zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave evropiane në nivel të sistemit statistikor kombëtar, përkatësisht të sistemit statistikor evropian. Autoritetet statistikore bashkëpunojnë në mënyrë aktive brenda partneritetit të Sistemit Evropian të Statistikave, në mënyrë që të sigurojnë zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane.

TREGUESI

- 1bis.1 Institetet Statistikore Kombëtare koordinojnë aktivitetet statistikore të të gjitha autoriteteve të tjera kombëtare që zhvillojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë statistikën evropiane. Ata veprojnë në këtë drejtim si pika e vetme e kontaktit për Eurostatin në çështjet statistikore. Ekziston legjislacioni dhe procedurat e përcaktuara dhe të vendosura për zbatimin e rolit koordinues si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel evropian.
- 1bis.2 Udhëzimet kombëtare për të siguruar cilësi në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane brenda sistemit statistikor kombëtar prodhohen nga Udhëheqësit e Instituteve Kombëtare të Statistikave, aty ku është e nevojshme; zbatimi i tyre monitorohet dhe rishikohet.
- 1bis.3 Autoritetet statistikore vazhdimisht mbajnë dhe zhvillojnë bashkëpunim në nivele të ndryshme me njëri-tjetrin dhe me organet këshilluese të Sistemit Evropian të Statistikave, si dhe me anëtarët e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, institucionet akademike dhe organet e tjera ndërkombëtare, sipas rastit.

## PARIMI 2

**Mandati për Mbledhjen e të Dhënave dhe Qasjen në të Dhëna**  
Autoritetet statistikore kanë mandat të qartë ligjor për mbledhjen dhe qasjen në informacion nga burime të shumta të të dhënave, për qëllime statistikore Evropiane. Administratat, ndërmarrjet, ekonomitë familjare dhe publiku në përgjithësi mund të obligohen me ligj të lejojnë qasjen ose të ofrojnë të dhëna për qëllime të statistikave Evropiane, me kërkesën e autoriteteve statistikore.

TREGUESI

- 2.1** Mandati i autoriteteve statistikore për mbledhjen dhe qasjen në informacione për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e Statistikave Evropiane është i specifikuar me ligj.
- 2.2** Autoriteteve statistikore u lejohej me ligj që të kenë qasje në të dhënat administrative, menjëherë dhe pa pagesë, dhe t'i përdorin ato për qëllime statistikore. Ata janë të përfshirë qysh në fillim në përpilimin, zhvillimin dhe ndërprerjen e regjistrave administrativë në mënyrë që t'i bëjnë ato më të përshtatshme për qëllime statistikore.
- 2.3** Mbi bazën ligjore, autoritetet statistikore mund të kërkojnë me detyrim përgjigjen në anketat statistikore.
- 2.4** Qasja në të dhëna të tjera për qëllime të statistikave, siç janë të dhënat private, lehtësohet duke siguruar konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave.

## PARIMI 3

### Resurset e mjaftueshme

Burimet (ose resurset) që janë në dispozicion për autoritetet statistikore, janë të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të Statistikave Evropiane.

TREGUESI

- 3.1** Burimet njerëzore, financiare dhe kompjuterike, në sasi dhe cilësi, janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojat statistikore.
- 3.2** Përmasat, detajet dhe kostoja e statistikave janë në përputhje me nevojat.
- 3.3** Ekzistojnë procedura për vlerësimin dhe arsyetimin e kërkesave për statistika të reja përkundër kostos së tyre.
- 3.4** Ekzistojnë procedura për vlerësimin e nevojave të vazhdueshme për statistika, për të parë nëse diçka mund të ndërpritet ose reduktohet për të kursyer burimet.

## PARIMI 4

### Përkushtimi ndaj Cilësisë

Autoritetet statistikore janë të përkushtuara për cilësi. Ato, në mënyrë sistematike dhe të rregullt, identifikojnë përparësitë dhe mangësitë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së proceseve dhe produkteve.

TREGUESI

- 4.1** Politika e cilësisë është e definuar dhe publike. Ekziston një strukturë organizative dhe mjetet/instrumentet për trajtimin e menaxhimit të cilësisë.
- 4.2** Ekzistojnë procedura për planifikimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në proceset statistikore, përfshirë integrimin e të dhënave që vijnë nga burime të shumta të të dhënave.
- 4.3** Cilësia e prodhimit monitorohet rregullisht, vlerësohet në aspektin e përfitimeve dhe lëshimeve dhe raportohet sipas kriterëve për cilësi për Statistikat Evropiane.
- 4.4** Ekziston një rishikim i rregullt dhe i thellë i produkteve kryesore statistikore duke angazhuar edhe ekspertë të jashtëm, nëse e nevojshme.

## PARIMI 5

### Konfidencialiteti Statistikor dhe Mbrojtja e të Dhënave

Privatësia e ofruesve të të dhënave, konfidencialiteti i informatave që ata ofrojnë, përdorimi i tyre vetëm për qëllime statistikore dhe siguria e të dhënave garantohen plotësisht.

TREGUESI

- 5.1** Konfidencialiteti në statistikë garantohet me ligj.
- 5.2** Staf i nënshkruan dokumentin për respektimin e konfidencialitetit.
- 5.3** Jepen dënime për shkelje me paramendim të konfidencialitetit në statistikë.
- 5.4** Staf i pajiset me udhëzimet dhe instruksione për ruajtjen e konfidencialitetit në proceset statistikore. Kjo politikë për ruajtjen e konfidencialitetit bëhet publike.
- 5.5** Vendosen masat e nevojshme rregulluese, administrative, teknike dhe organizative për të mbrojtur sigurinë dhe integritetin e të dhënave statistikore dhe transmetimin e tyre, në përputhje me praktikën më të mira, standardet ndërkombëtare, si dhe legjislacionin evropian dhe kombëtar.

## PARIMI 6

### Paanshmëria dhe Objektiviteti

Autoritetet statistikore zhvillojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë Statistikat Evropiane duke respektuar pavarësinë shkencore dhe në mënyrë objektive, profesionale dhe transparente ku të gjithë përdoruesit trajtohen njësoj.

TREGUESI

- 6.1** Statistikat përpilohen në mënyrë objektive duke pasur për bazë faktet statistikore.
- 6.2** Përzgjedhja e burimeve të të dhënave, metodave statistikore dhe vendimet për shpërndarjen e statistikave bazohen në faktet statistikore.
- 6.3** Gabimet e zbuluara në statistikat e publikuara korrigjohen sa më herët që është e mundur dhe bëhen publike.
- 6.4** Informacionet mbi burimet e të dhënave, metodat dhe procedurat e përdorura bëhen publike.
- 6.5** Datat dhe afatet e publikimeve statistikore paralajmërohen.
- 6.6** Paralajmërohet për ndonjë rishikim të gjerë ose ndryshim të metodologjisë.
- 6.7** Autoritetet statistikore vendosin në mënyrë të pavarur për kohën dhe përmbajtjen e publikimeve statistikore, duke marrë parasysh qëllimin e sigurimit të informacionit statistikor të plotë dhe në kohë. Të gjithë përdoruesit kanë qasje të barabartë në publikimet statistikore në të njëjtën kohë. Qasjet e privileguara, të parakohshme për ndonjë përdorues të jashtëm, janë të kufizuara, të kontrolluara dhe publike. Në rast se ndodh qasje e parakohshme e paplanifikuar, duhet të rishikohet koha e publikimit dhe të bëhet për të gjithë njësoj në mënyrë që të sigurohet paanshmëria.
- 6.8** Publikimet dhe deklaratat statistikore të bëra në konferencat për shtyp duhet të jenë objektive dhe të paanshme.

## Proceset statistikore

Standardet evropiane dhe standardet e tjera ndërkombëtare, udhëzuesit dhe praktikat e mira respektohen plotësisht në proceset statistikore që përdoren nga autoritetet statistikore për të zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë Statistikat Evropiane, ndërkohë që bëhen përpjekje të vazhdueshme për inovacion. Kredibiliteti i statistikave rritet me reputacionin e menaxhimit të mirë dhe efikas. Parimet janë metodologjia e duhur, procedurat e duhura statistikore, ngarkesa jo e tepruar për të anketuarit dhe kosto-efektiviteti.

## PARIMI 7

### Metodologjia e duhur

Metodologjia e duhur fuqizon cilësinë e statistikave. Kjo kërkon mjetet, procedurat dhe ekspertizën adekuate.

TREGUESI

- 7.1** Korniza e përgjithshme metodologjike e përdorur për Statistikat Evropiane i përmbahet standardeve, udhëzuesve dhe praktikave të mira evropiane dhe ndërkombëtare, ndërsa përpiqet vazhdimisht për inovacion.
- 7.2** Ekzistojnë procedura që sigurojnë që konceptet, përkufizimet, dhe klasifikimet standarde përdoren në tërë autoritetin statistikor.
- 7.3** Regjistrat dhe kornizat e përdorura për Statistikat Evropiane vlerësohen dhe rregullohen rregullisht nëse e nevojshme për të siguruar cilësi të lartë.
- 7.4** Ka përputhje në detaje midis sistemeve kombëtare të klasifikimeve dhe sistemeve përkatëse evropiane.
- 7.5** Rekrutohen të diplomuarit në disiplina akademike përkatëse.
- 7.6** Autoritetet statistikore zbatojnë politikën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të tyre.
- 7.7** Organizohen bashkëpunime me komunitetin shkencor për të siguruar përmirësimin e metodologjisë, efektivitetit të metodave të përdorura dhe promovimin e instrumenteve më të mira, kur është e mundur.

## PARIMI 8

### Procedurat e duhura statistikore

Procedurat e duhura statistikore, nga mbledhja e të dhënave deri te validimi i tyre, fuqizojnë cilësinë e statistikave.

#### TREGUESI

- 8.1** Në rastet kur Statistikat Evropiane bazohen në të dhëna administrative, përkufizimet dhe konceptet e përdorura për qëllime administrative janë të ngashme me ato që kërkohen për qëllime statistikore.
- 8.2** Në rastin e anketave statistikore, pyetësorët testohen sistematikisht para mbledhjes së të dhënave.
- 8.3** Dizajnet e anketave, përzgjedhja e mostrave dhe metodat e vlerësimeve janë të bazuara dhe rishikohen rregullisht, sipas nevojës.
- 8.4** Metadat, që lidhen me proceset statistikore, menaxhohen gjatë tërë proceseve statistikore dhe shpërndahen, sipas nevojës.
- 8.5** Rishikimet bazohen në procedura standarde, mirë të përcaktuara dhe transparente.
- 8.6** Ekzistojnë marrëveshje me përgjegjësit e të dhënave administrative mbi përdorimin e këtyre të dhënave për qëllime statistikore.
- 8.7** Autoritetet statistikore bashkëpunojnë me përgjegjësit për të dhënat administrative në sigurimin e cilësisë së të dhënave.

## PARIMI 9

### Ngarkesë jo e tepruar mbi të anketuarit

Ngarkesa për raportim të të dhënave është në përputhje me nevojat e përdoruesve dhe jo e tepruar për të anketuarit/intervistuarit. Autoritetet statistikore monitorojnë ngarkesën për raportim të dhënash nga të anketuarit dhe caktojnë objektiva për reduktimin e kësaj ngarkese me kalimin e kohës.

#### TREGUESI

- 9.1** Përmasat dhe detajet e kërkesave të Statistikave Evropiane kufizohen në atë që është absolutisht e nevojshme.
- 9.2** Ngarkesa për raportim të dhënash shpërndahet sa më shumë që është e mundur në popullatat e anketuara dhe monitorohet nga autoriteti statistikor.

- 9.3** Informacionet e kërkuara nga bizneset janë, sa më shumë që është e mundur, të gatshme nga pasqyrat e tyre dhe përdoren mjetet elektronike për marrjen e këtyre informacioneve.

- 9.4** Burimet e administrative përdoren aty ku është e mundur për të evituar kërkesat e tepërta.

- 9.5** Shkëmbimi i të dhënave dhe integrimi i tyre, duke iu përmbajtur konfidencialitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të dhënave, promovohen me qëllim të reduktimit të ngarkesës të të anketuarve për raportim të të dhënave.

- 9.6** Autoritetet statistikore promovojnë masa që mundësojnë lidhjen e burimeve të të dhënave me qëllim të reduktimit të ngarkesës të të anketuarve për raportim të të dhënave.

## PARIMI 10

### Kost efektiviteti

Burimet përdoren në mënyrë efektive.

#### TREGUESI

- 10.1** Masa të pavarura, të brendshme dhe të jashtme, monitorojnë përdorimin e burimeve (ose resurseve) nga ana e autoritetit statistikor.
- 10.2** Teknologjia informative dhe e komunikimit optimizohet për mbledhjen, procesimin dhe shpërndarjen e të dhënave.
- 10.3** Bëhen përpjekje proaktive për përmirësimin e potencialit të të dhënave administrative dhe kufizimin e përdorimit të resurseve për anketa direkte.
- 10.4** Autoritetet statistikore promovojnë dhe implementojnë programe të standardizuara, që rrisin efektivitetin dhe efikasitetin.



## Produkti Statistikor

Statistikat aktuale plotësojnë nevojat e përdoruesve. Statistikat janë në përputhje me standardet Evropiane të cilësisë dhe i shërbejnë nevojave të institucioneve Evropiane, qeverive, instituteve hulumtuese, biznesit dhe publikut të gjerë. Informatat e rëndësishme lidhur me relevancën e statistikave, saktësinë, besueshmërinë, afatet kohore, koherencën dhe krahasueshmërinë midis rajoneve dhe vendve janë në dispozicion për përdoruesit.

### PARIMI 11

#### Relevanca

TREGUESI Statistikat Evropiane plotësojnë nevojat e përdoruesve.

**11.1** Ekzistojnë procese për konsultimin me përdoruesit, monitorimin e relevancës dhe shfrytëzueshmërisë së statistikave ekzistuese në plotësimin e nevojave të tyre, si dhe marrjen në konsideratë të nevojave dhe prioriteteve të reja të tyre. Inovacionet po përcjellen për të përmirësuar vazhdimisht prodhimin e statistikave.

**11.2** Nevojat prioritare plotësohen dhe kjo reflektohet në programin e punës.

**11.3** Kënaqshmëria e përdoruesve monitorohet rregullisht dhe përcillet sistematikisht.

### PARIMI 12

#### Saktësia dhe Besueshmëria

TREGUESI Statistikat Evropiane në mënyrë të saktë dhe të besueshme reflektojnë realitetin.

**12.1** Të dhënat burimore, rezultatet preliminare dhe produktet statistikore vlerësohen dhe validohen rregullisht.

**12.2** Gabimet e mostrimit dhe ato, që nuk lidhen me mostrën, maten dhe dokumentohen sistematikisht sipas standardeve Evropiane.

**12.3** Rishikimet analizohen rregullisht me qëllim të përmirësimit të proceseve statistikore.

### PARIMI 13

#### Afatet kohore dhe përpikëria

TREGUESI Statistikat Evropiane publikohen me kohë dhe përpikëri.

**13.1** Afatet kohore janë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për publikimet.

**13.2** Ekziston një kohë/orë standarde brenda ditës kur bëhet publikimi i statistikave.

**13.3** Periodiciteti i statistikave merr parasysh kërkesat e përdoruesve, sa më shumë që është e mundur.

**13.4** Devijimi nga afati i shpërndarjes publikohet paraprakisht, shpjegohet dhe caktohet një datë e re e publikimit.

**13.5** Rezultatet preliminare me saktësi të pranueshme mund të publikohen, kur të konsiderohet e dobishme.

### PARIMI 14

#### Koherenca dhe Krahasueshmëria

TREGUESI Statistikat Evropiane kanë konsistencë të brendshme, nëpër periudha kohore dhe janë të krahasueshme midis rajoneve dhe vendeve; është e mundur të kombinohen dhe të përdoren të dhëna që kanë lidhje mes vete, nga nga burime të ndryshme.

**14.1** Statistikat kanë koherencë të brendshme dhe janë konsistente (p.sh. identitetet aritmetike dhe kontabël).

**14.2** Statistikat janë të krahasueshme përgjatë një periudhe të arsyeshme kohore.

**14.3** Statistikat përpilohen mbi bazën e standardeve të përbashkëta në lidhje me fushë-shtrirjen, përkufizimet, njësitë dhe klasifikimet në anketa dhe burimet e ndryshme.

**14.4** Statistikat nga burimet e ndryshme dhe me periodicitet të ndryshëm krahasohen dhe përputhen.

**14.5** Krahasimi i të dhënave brenda vendit sigurohet në kuadër të Sistemit Statistikor Evropian përmes shkëmbimeve periodike midis SSE dhe sistemeve të tjera statistikore. Bëhen analiza të metodologjisë në bashkëpunim të ngushtë midis vendeve anëtare dhe Eurostatit.

## PARIMI 15

### Qasja dhe Qartësia

Statistikat Evropiane paraqiten në një formë të qartë dhe të kuptueshme, publikohen në format të përshtatshëm, janë në dispozicion, të paanshme dhe të shoqëruara me metadatat dhe udhëzuesit përkatës.

#### TREGUESI

- 15.1** Statistikat dhe metadatat korresponduese paraqiten dhe arkivohen në format të tillë që lehtëson interpretimin e lehtë të tyre dhe krahasimet e nevojshme.
- 15.2** Shërbimi e shpërndarjes përdor teknologjinë informative dhe të komunikimit, dhe nëse e nevojshme, kopjet e shtypura në letër.
- 15.3** Analizat specifike sipas kërkesës ofrohen kur është e mundur dhe informohet publiku për këtë.
- 15.4** Qasja në të dhënat mikro lejohet për qëllime hulumtimi, në bazë të rregullave ose protokolleve specifike.
- 15.5** Metadatat dokumentohen sipas sistemeve të standardizuara për metadata.
- 15.6** Përdoruesit informohen lidhur me metodologjinë e proceseve statistikore, përfshirë përdorimin e të dhënave administrative.
- 15.7** Përdoruesit informohen lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas kriterëve të cilësisë për Statistikat Evropiane.

Për më shumë informata rreth Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane <http://ec.europa.eu/eurostat/ëeb/quality/overvieë>  
Email: [ESTAT-QUALITY@ec.europa.eu](mailto:ESTAT-QUALITY@ec.europa.eu)



Publications Office

Print [KS-02-18-142-EN-C](#)

PDF [KS-02-18-142-EN-N](#)